

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2024

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi I Kërkesës	Tarifa
1	09.01.2024	<i>Kërkim informacioni sa është vlera totale për ndihmë sociale që është dhënë për gratë/femrat e dhunuar të ndara sipas viteve 2020-2023? Buxheti I bashkisë për dhunën në familje për vitet 2020-2023? Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar subvencionim të qirasë/bonus qeraje nga bashkia për vitet 2020-2023? Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar kredi të buta për vitet 2020-2023? (sa kanë aplikuar dhe sa kanë përfituar). Cila është problematika më e madhe që keni ndeshur për të ndihmuar/mbështetur gratë/femrat e dhunuara përgjatë këtyre viteve 2020-2023?</i>	19.01.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
2	12.01.2024	<i>Kërkim informacioni për shumën vjetore të shpenzuar nga Bashkia për vitin 2023 për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare web të Bashkisë Gramsh? (në lekë), A ka Bashkia juaj një program të miratuar transparence dhe nëse po kur është miratuar ai (viti)?, Sa është numri i kërkesave për informim që kanë ardhur vetëm elektronikisht në bashkinë tuaj?</i>	17.01.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>

3	31.01.2024	<p><i>Kërkim informacioni për çfarë ka ndodhur me parcelën la, me sipërfaqe 7.9 hektarë? Me çfarë VKM është hequr kjo parcelë? Çfarë ka ndodhur me parcelën 7a, me sipërfaqe 47 hektarë? Çfarë ka ndodhur me parcelën 8a, me sipërfaqe 22 hektarë? Çfarë ka ndodhur me parcelën 9a, me sipërfaqe 39.9 hektarë?</i></p> <p><i>Në bazë të Udhëzimit nr.1 "PËR MBAJTJEN E KADASTRËS SË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBËTAR" kërkohet të dhënat kadastrale për Ekonominë Pyjore Gramsh-Vine nga viti 2015 deri në 31 dhjetor 2023, së bashku me miratimet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Të dhënat duhet të jenë për të dyja periudhat vjetore të raportimit. Po ashtu kërkohet hartat përkatëse në rastin e ndryshimeve si dhe dokumentin që ka miratuar këto ndryshime.</i></p>	08.01.2024	Përfunduar	Nuk ka
4	21.02.2024	<p><i>Kërkim informacioni për, a kanë përfituar OJFtë fonde publike nga institucioni juaj gjatë vitit 2023, Nëse po, cila ka qenë forma e përfitimit të këtyre fondeve (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? Sa OJF kanë aplikuar për fonde publike pranë institucionit tuaj gjatë vitit 2023? Ju lutem, specifikoni sipas formës, nëse ka patur më shumë se një formë. Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde publike? Bashkëngjisni listën e fituesve së bashku me buxhetet përkatëse. Specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë. Keni ofruar mbështetje jo-financiare për OJFtë gjatë vitit 2023? Nëse po, specifikoni bazën ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje? Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare gjatë vitit, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj.)?</i></p>	27.02.2024	Përfunduar	Nuk ka

5	01.03.2024	<i>Kërkim informacioni për delegimin e kompetencave ligjore të një vartësi, a janë bërë zëvendësimi/kalimi I këtyre kompetencave ligjore, nëse po, urdhërin?</i>	04.03.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
6	11.03.2024	<i>Kërkim informacioni për të dhëna të përgjithshme në Bashkin Gramsh, projekti STAR 3.</i>	12.03.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
7	27.03.2024	<i>Kërkim informacioni për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e tyre.</i>	15.04.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
8	04.06.2024	<i>Kërkim informacioni të përgjithshëm për rinin dhe sektorin e turizmit në Bashkin Gramsh.</i>	11.06.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
9	21.06.2024	<i>Kërkim informacioni për disa drejtori dhe sektor në Bashkin Gramsh, kontaktet (emer/mbiemre/email/nr. Kontakti) të drejtorive dhe personat përgjegjës: Drejtoris juridike, Drejtoria arsimit parashkollor, Drejtoria e financa dhe buxhetit, përgjegjës I ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar etj.</i>	24.06.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
10	08.07.2024	<i>Kërkim informacioni për planin e veprimt për eficiencën e energjisë në bashkinë Gramsh? Cilat janë hapat e ndërmarra për zbatimin e këtij plani? Nëse ky dokument nuk është hartuar ende, cilat janë arsyet? Çfarë hapash parashikohet të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin/hartimin e planit të veprimt për eficiencën e energjisë?</i>	23.07.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
11	16.07.2024	<i>Kërkesë për informacion mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjinë hidrike HEC në territorin e bashkisë Gramsh nga viti 2008 e deri më sot. Sa sipërfaqe janë pyllëzuar? Në cilat parcela dhe ekonomi pyjore është bërë investimi? A ka patur investime të tjera përveç pyllëzimeve? Nëse po ku dhe çfarë investimi?</i>	24.07.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>

12	30.07.2024	<i>Kërkim informacioni për hartimin e planit vendor të veprimit për eficientë e energjisë dhe klimës? Nëse bashkia nuk e ka hartuar planin vendor të veprimit për eficientë e energjisë dhe klimën? Thirrje e publikut në vendimmarje, zbatimi i masave të eficientës së energjisë dhe cilat janë sfidat kryesore që has bashkia në zbatimin e masave të eficientës së energjisë dhe klimës?</i>	08.08.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
13	23.09.2024	<i>Kërkim informacioni për planin social ose strategjisë për të rinjtë e bashkisë tuaj, kopje ose link (nese ka), Listë të investimeve nga buxheti I bashkisë kushtuar të rinjve në Bashkinë Gramsh, zërat ne buxhet nese është I vecuar për aktivitetet rinore sensibilizuese (Link ose kopje dokumenti), Plani për investimet për të rinjtë në vitin 2025 (nëse është parashikuar kopje të dokumentit).</i>	01.10.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
14	26.09.2024	<i>Kërkim informacioni për sipërfaqet e Fondit Pyjor nga viti 2016 sa janë që ju kanë kaluar pronarëve privatë? Në cilat ekonomi dhe parcela?</i>	10.10.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>
15	11.10.2024	<i>Kërkim informacioni për kopje të Urdhërit nr.251, datë 18.08.2022, në bazë të të cilit MTM ka miratuar planet e mbarështrimit për Ekonomitë Pyjore në Bashkinë Gramsh.</i>	18.10.2024	<i>Përfunduar</i>	<i>Nuk ka</i>

16	22.10.2024	<p><i>Kërkim informacioni për, a ka bashkia nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar? A ka aplikuar Bashkia Gramsh per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2024? Sa ka qene vlere totale e miratuar nga MSHMS per vitin 2024 dhe per cilat kategori sherbimesh do te perdoren? A eshte disbursuar ne masen 100% fondi i kushtezuar i MSHMS per vitin 2024? A keni perthithur fonde nga Fondi Social per vitin 2023, ne cfare vlere ka qene fondi i perfituar dhe per cilat kategori sherbimesh jane perdorur? Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023 dhe 2024? A keni parashikuar ne buxhetin afatmesem 2025-2027 ngritje te fondeve per te mbajtur ne funksion sherbimet e ofruara ne territor edhe pas perfundimit te financimit te Fondit Social? Cilat jane kategorite e shtesave vulnerabel te identifikuara ne bashkine tuaj qe mund te perfitojne nga sherbimet sociale?</i></p>	29.10.2024	Përfunduar	Nuk ka
17	04.11.2024	<p><i>Kërkim nformacioni për: Sa është buxheti vjetor i bashkisë? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (të dhënat për 3 vitet e fundit) . A keni aplikuar në institucionet qendrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit). Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar? Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona? Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj?</i></p>	11.11.2024	Përfunduar	Nuk ka